



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

**P. nr.889/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm** , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit S. Th. nga fsh. X.K.R. , për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185/3 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1573/17 të dt.07.12.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **08.06.2018**, në prani të Prokurorit së shtetit Bajram Kryeziut dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **S.TH.** , i biri i F. dhe i nënës K. e gjinisë H. , data e lindjes ... në P., me banim në fsh. X. K-R., ,ka te kryer shkollën fillore ,i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë , i martuar ,atë i 2 fëmijëve , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, me ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

- me dt. 29.06.2017,rreth orës 20:10 min., ne Gjakovë , e kanosë personin tjetër me fjalë në atë mënyrë qe pasi i pandehuri kishte përfunduar ne emergjencën e Spitalit Rajonal “I. G. “ në Gjakovë , i njëjti pas kontrollit me udhëzimin e këtu të dëmtuarit S.B. , ishte nisur për ne QKUK-ë ku aty edhe ishte operuar , ashtu qe për një moment përmes numrit te telefonit ..... i ishte drejtuar me një mesazh kërcënues te dëmtuarit me këtë përmbajtje ” sapo te shërona kam për te shkuar ne burg doktor, S.Th.i jam ,ti kam prit njerëzit me mi pru te shpija, a po te doket qesharake dhimbjet e mëdha me kaluan , ndërsa burgun me këmbët thyer i mbaj “ veprime këto qe te dëmtuarit i shkaktuan frike dhe ankth ,ne atë mënyrë qe deri tek ky kërcënim kishte ardhur pasi qe i pandehuri ne Prishtinë gjoja kishte mësuar se ky operim ka mundur te realizohej edhe ne Gjakovë , gjegjësisht nga ana e te dëmtuarit .

**-me çka ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.3 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,17,41,45,46,73,74,75,76 dhe nenit 185 par. 3 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPP-ës.të akuzuarit i shqipton :

**DËNIM ME BURG**

**I. Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 180(një qind e tetëdhjetë)ditësh**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**Komform nënti 47 me kërkesën dhe pëlqimin e te akuzuarit S.Th. , dënimi i shqiptuar ne burgim ne kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë ) ditësh , i zëvendësohet me:**

## **DËNIM ME GJOBË**

**II. Me dënim me gjobë në shumën prej 900(nëntëqind ) euro ,të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit dhe atë kësti i parë ne shume prej 300 (treqind) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te pare pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, kësti i dyte prej 300 (treqind ) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te dytë, kësti i tretë prej 300 (treqind ) euro do te paguhet deri me datën 5 te muajit te tretë , pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit .**

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim ne kohëzgjatje të përcaktuar ne piken e I-rë te dispozitivit te këtij aktgjykimi.

I dëmtuari S.B. ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës dhe ne emër të paushallit gjyqësor shumë prej **20,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1573/17 të dt. 07.12.2017, e ka akuzuar të akuzuarin S.Th. nga fsh. X. K. R., për shkak të veprës penale te kanosjes nga neni 185/3 te KPRK-ës, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit .

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.08.06.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Bajram Kryeziu , lexojë aktakuzën PP.nr. 1573/17 te dt. 07.12.2017 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari S.Th. , gjate shqyrtimit fillestar, duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi te fajësisë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se këto verime i kam kryer në afekt-i mllëfesor, me qenë se trajtimi i im ka zgjatur shumë dhe kisha dhimbje të mëdha, për çka edhe jam drejtuar me mesazhe doktorit, me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer për veprën e kryer, premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet , kërkoj falje nga i dëmtuari për veprimet e mija , andaj i propozoj Gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë në çdo fazë të procedurës , pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla dhe do te jem me i kujdesshëm te me shqiptojë një dënim me te butë dhe nëse gjykata ka mundësi ligjore qe dënimin e shqiptuar te me zëvendësojë me dënim me gjobë.

Duke u deklarua lidhur me pranimin e fajësisë prokurori i shtetit Bajram Kryeziu deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari S.Th. , - me dt. 29.06.2017, rreth orës 20:10 min., ne Gjakovë , e kanosë personin tjetër me fjalë në atë mënyrë qe pasi i pandehuri kishte përfunduar ne emergjencën e Spitalit Rajonal “I. G. “ në Gjakovë , i njëjti pas kontrollit me udhëzimin e këtu te dëmtuarit S.B. , ishte nisur për ne QKUK-ë ku aty edhe ishte operuar , ashtu qe për një moment përmes numrit te telefonit ..... i ishte drejtuar me një mesazh kërcënues te dëmtuarit me këtë përmbajtje ” sapo te shërona kam për te shkuar ne burg doktor, S. Th. jam ,ti kam prit njerëzit me mi pru te shpija, a po te doket qesharake dhimbjet e mëdha me kaluan , ndërsa burgun me këmbët thyer i mbaj “ veprime këto qe te dëmtuarit i shkaktuan frike dhe ankth ,ne atë mënyrë qe deri tek ky kërcënim kishte ardhur pasi qe i pandehuri ne Prishtinë gjoja kishte mësuar se ky operim ka mundur te realizohej edhe ne Gjakovë , gjegjësisht nga ana e te dëmtuarit

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e te akuzuarit , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës , pendimin e tij , sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, kështu qe duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit bazuar ne neni 76 te KPRK-së dhe te akuzuarit i ka shqiptuar dënimin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **180(një qind e tetëdhjetë) ditësh**, me bindje e plotë se ky dënim është ne harmoni me peshën e veprës penale ,shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit , personalitetin e te akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj te akuzuarit do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës.

Pas shpalljes së aktgjykimit, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit S.Th. , Gjykata ne kuptim te dispozitës te nenit 47, dënimin e shqiptuar me burgim e ka zëvendësuar me dënim me gjobe me pëlqimin e personit te dënuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, me shpresë dhe bindje se me dënimin e shqiptuar, do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.889/17 më datë 08.06.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë . Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.